

Leksikologji me semantikë

Syllabusi 2013/2014

Universiteti i Prishtinës

Fakulteti i Filologjisë/ Departamenti i Gjuhës Shqipe

Niveli dhe lloji i kursit: (Bachelor/obligative)

Viti i studimeve dhe semestri: Viti I- Semestri I

Numri i orëve në javë: 2+2

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS : 8

Mësimdhënësi i kursit:

Prof. ass. dr. Shkumbin Munishi

Detajet kontaktuese:

Zyra 142

Tel: 044 124 290

Email: shmunishi@hotmail.com

Qëllimet e kursit (modulit):

Në këtë modul do të trajtohen aspekte të ndryshme të problemeve nga fusha e leksikologjisë dhe semantikës. Objektivi i kësaj lënde është që t'u ndihmojë studentëve të nxënë njohuritë themelore nga fusha e leksikologjisë, semantikës dhe leksikografisë. Pra, të kuptojnë se cila është natyra e njësive të leksikut, ta njohin funksionin dhe kuptimin e tyre.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jenë në gjendje që:

- të njohin konceptet themelore nga fusha e leksikologjisë dhe semantikës
- t'i njohin njësitë e leksikut dhe të dallojnë formën dhe kuptimin e tyre
- ta njohin strukturën e njësive semantike
- t'i njohin lëvizjet semantike dhe ndikimin e tyre në sistemin leksikor të gjuhës shqipe
- t'i njohë shtresat e leksikut, stilet dhe ligjërimet në gjuhën shqipe standarde
- të fitojnë njohuri themelore nga fusha e leksikografisë

Metodologjia e mësimdhënies:

Ligjërata, diskutim, seminare/ese.

Literatura bazë:

Jani Thomaj, Leksikologjia e gjuhës shqipe, SHBLU, Tiranë, 2002.

Java e parë: Hyrje në leksikologjinë shqipe; fusha e studimeve dhe lidhja e leksikologjisë me disiplinat e tjera të gjuhësisë (Literatura: Thomaj, 2002, fq. 9-22)

Java e dytë: Gjuha si sistem i shenjave; shenja, i shënjuari dhe shënjuesi, (Literatura: përmbledhje ligjëratash mbi shenjën; ekstrakte dhe materiale nga libri i Ferdinand de Saussure, Kurs i gjuhësisë së përgjithshme)

Java e tretë: Fjala si njësi leksikore në gjuhën shqipe; veçoritë dhe struktura e fjalës (Literatura: Thomaj, 2002, fq. 25-42)

Java e katërt: Homonimet në gjuhën shqipe; zhvillimi historik i fjalëve dhe vlera e tyre në gjuhën shqipe (Literatura: Thomaj, 2002, fq. 42-63)

Java e pestë: Semantika leksikore; historia dhe zhvillimi i semantikës; zhvillimi i semantikës shqipe (Literatura: Thomaj, 2002, fq. 63-89)

Java e gjashtë: Kategoritë themelore të semantikës: kuptimi leksikor dhe lëvizja kuptimore (Literatura: Thomaj, 2002, fq. 81-89)

Java e shtatë: Struktura e kuptimit leksikor dhe teoria e fushave semantike (Literatura: Thomaj, 2002, fq. 89-97)

Vlerësimi intermediar

Java e tetë: Dukuritë e semantikës leksikore; prejardhja e kuptimeve në gjuhën shqipe dhe nxjerrja e përbërësve kuptimorë (Literatura: Thomaj, 2002, fq. 97-108)

Java e nëntë: Ngjyrimet emocionuese të fjalëve (Literatura: Thomaj, 2002, fq. 108-113)

Java e dhjetë: Fjalët me shumë kuptime, lëvizjet kuptimore gjatë formimit të fjalëve; tipat e kuptimeve të fjalëve (Literatura: Thomaj, 2002, fq. 113-137)

Java e njëmbëdhjetë: Sinonimet dhe antonimet në gjuhën shqipe (Literatura: Thomaj, 2002, fq. 137-150)

Java e dymbëdhjetë: Grupe paradigmatiche të fjalëve sipas ndërtimit: fjalët e formuara me ndajshesa dhe pa ndajshesa; fjalët e formuara me përbërje dhe përngjitje në gjuhën shqipe (Literatura: Thomaj, 2002, fq. 153-169)

Java e trembëdhjetë: Togfjalëshat dhe njësitë frazeologjike; klasifikimi i njësive frazeologjike në gjuhën shqipe (Literatura: Thomaj, 2002, f. 179-215)

Java e katërbëdhjetë: Leksiku i gjuhës shqipe; shtresëzimet e leksikut të shqipes sipas burimi dhe sipas përdorimit; leksiku i gjuhës standard shqipe; ligjërimet dhe stilet funksionale (Literatura: Thomaj, 2002, fq. 221-275)

Java e pesëmbëdhjetë: Leksikografia shqipe (Literatura: Thomaj, 2002, fq. 275- 301)

Vlerësimi përfundimtar

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi gjysmësemestral: 35%
Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 10%
Vijimi i rregullt: 5%
Provimi final: 50%
Totali: 100%

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët duhet t'i ndjekin me rregull ligjërata. Në rast të mungesave të shumta të paarsyeshme studentëve nuk do t'u verifikohet pjesëmarrja e rregullt në ligjërata e ushtrime. Prania e studentëve në ligjërata dhe në ushtrime shënohet në fletat e evidencës. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t'i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave.

Literatura shtesë dhe bibliografia:

Jackson, Howard – Amvela Ze, Etienne, Words, Meaning, Vocabulary. Continuum. London, New York, 2004.

Thomaj, Jani, Prejardhja semantike në gjuhën shqipe, Tiranë, 1988.